



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**AUTORITETI I KONKURENCËS**  
**DREJTORIA E ANALIZËS DHE METODOLIGJISË SË TREGJEVE**

**NJOFTIM**

**Rasti:** Përftimi i kontrollit të shoqërisë paragon semvox GmbH nga shoqëria CARIAD SE.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është protokolluar shkresa nr.699 prot.i AK, datë 02.12.2022, “Volkswagen Aktiengesellschaft / paragon semvox GmbH”, me të cilën jemi njoftuar në lidhje me transaksionin e përfitimit të kontrollit të vetëm mbi shoqërinë paragon semvox GmbH nga shoqëria CARIAD SE.

Referuar marrëveshjes, palët janë:

**Pala blerëse: CARIAD SE** është një shoqëri evropiane, e themeluar sipas legjislacionit gjerman, me objekt aktiviteti: zhvillimin dhe shitjen e zgjidhjeve softuerike për industrinë automobilistike dhe pjesëmarrjen në shoqëri të të gjitha llojeve, veçanërisht në industrinë e softuerit. CARIAD SE është një filial në pronësi të plotë të Volkswagen Aktiengesellschaft (Volkswagen AG), ndërmarrja mëmë e Grupit Volkswagen.

Volkswagen AG operon në Shqipëri përmes shoqërive të zotëruar indirekt prej tij, Porsche Albania SHPK dhe Porsche Leasing SHPK.

**Pala shitëse: paragon GmbH & Co. KGaA** është një ortakëri e kufizuar me aksione, me objekt aktiviteti: kërkim dhe zhvillim në fushën e mikroelektronikës, prodhimit dhe shitjes së pajisjeve elektronike, pajisjeve periferike dhe montimeve përkatëse etj.

**Shoqëria Target: paragon semvox GmbH** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit gjerman. Paragon semvox GmbH është një ofrues (inxhinier), rishitës dhe licencues i zgjidhjeve dhe teknologjisë softuerike të asistentëve digjitalë të AI (inteligjencë artificiale) me aktivizim zanor, me fokus në zgjidhjet për industrinë e automjeteve.

Target nuk është aktiv dhe nuk gjeneron të ardhura në tregun shqiptar.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al).**